



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 92

Tiranë – E martë, 31 maj 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 45/2016 datë 28.4.2016	Për vullnetarizmin..... 5219
Ligj nr. 49/2016 datë 5.5.2016	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullosor”, të ndryshuar..... 5223



LIGJ
Nr. 45/2016

PËR VULLNETARIZMIN

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e deputeteve Kejdi Mehmetaj dhe Silva Caka,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj përcakton parimet kryesore, si dhe kushtet dhe kriteret për kryerjen e vullnetarizmit në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2
Qëllimi

Ky ligj synon rregullimin ligjor të vullnetarizmit, me qëllim rritjen e angazhimit qytetar dhe rritjen e pjesëmarrjes së individëve në jetën sociale për përmirësimin e cilësisë së jetës në komunitet, si dhe zhvillimin e vlerave të solidaritetit njerëzor.

Neni 3
Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për të gjitha subjektet që kryejnë, përfitojnë ose ofrojnë vullnetarizëm në Republikën e Shqipërisë.

2. Ky ligj nuk zbatohet për:

a) kryerjen e punëve ose shërbimeve që një person është i detyruar t'i kryejë për një person tjetër, sipas legjislacionit në fuqi dhe që nuk janë objekt i këtij ligji;

b) kryerjen e punëve ose shërbimeve që janë të zakonshme në familje, shoqëri apo në marrëdhëniet e fqinjësisë;

c) dhurimin e gjakut;

ç) realizimin e detyrimeve të caktuara me vendim gjykatë të formës së prerë.

Neni 4
Vullnetarizmi

1. Vullnetarizmi është investimi me vullnet të lirë i kohës, njohurive dhe aftësive për kryerjen e aktiviteteve ose shërbimeve nga vullnetari, në dobi të ofruesit dhe/apo përfituesit të vullnetarizmit.

2. Vullnetarizmi kryhet pa pagesë, pa kompensim ose ndonjë përfitim tjetër material, përveç rasteve kur ky ligj parashikon ndryshe.

Neni 5
Vullnetari

Vullnetar, në kuptim të këtij ligji, është:

a) çdo person, vendas ose i huaj, që gëzon zotësi të plotë për të vepruar, sipas legjislacionit në fuqi dhe me vullnet të lirë kryen vullnetarizëm;

b) çdo person me aftësi të kufizuara, i cili mund të kryejë vullnetarizëm, në përputhje me aftësitë dhe zhvillimin e tij fizik e mendor;

c) çdo i mitur i moshës 15 deri 18 vjeç, sipas përcaktimeve të nenit 6 të këtij ligji.

Neni 6
Vullnetari i mitur

1. Vullnetari i mitur mund të lidhë kontratë vullnetarizmi vetëm me pëlqimin me shkrim të prindit ose përfaqësuesit të tij ligjor.

2. Rregullat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për marrëdhëniet e punës, të cilat trajtojnë mbrojtjen e një punëmarrësi të mitur, do të zbatohen edhe për mbrojtjen e vullnetarit të mitur.

Neni 7
Vullnetari i huaj

Vullnetari, i cili nuk është shtetas shqiptar, ka të drejtë të kryejë vullnetarizëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, me kusht që të jetë i pajisur me leje qëndrimi të përkohshme ose të përhershme, të lëshuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për të huajt.



Neni 8

Shtetasi shqiptar që kryen vullnetarizëm jashtë vendit

Shtetasi shqiptar mund të kryejë vullnetarizëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me aktet ndërkombëtare dhe rregullat e përcaktuara në legjislacionin e vendit ku do të kryhet vullnetarizmi.

Neni 9

Ofruesi i vullnetarizmit

1. Ofrues i vullnetarizmit mund të jetë një organ publik, bashkësi fetare ose organizatë jofitimprurëse.

2. Ofrues i vullnetarizmit mund të jetë edhe një person juridik vendas ose i huaj, i cili në ofrimin e vullnetarizmit, në përputhje me këtë ligj, nuk synon veprimtari fitimprurëse.

Neni 10

Përfituesi i vullnetarizmit

1. Përfituesi i vullnetarizmit mund të jetë një person fizik ose juridik, vendas ose i huaj.

2. Përfituesi i vullnetarizmit mund të jetë në të njëjtën kohë edhe ofrues i vullnetarizmit.

Neni 11

Kohëzgjatja e vullnetarizmit

1. Kohëzgjatja ditore e vullnetarizmit është jo më shumë se 5 orë në ditë.

2. Kohëzgjatja javore e vullnetarizmit është jo më shumë se 25 orë në javë.

Neni 12

Ndalimi i diskriminimit

Ndalohet çdo lloj diskriminimi i bërë ndaj vullnetarit gjatë kohëzgjatjes së vullnetarizmit, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 13

Mbrojtja e personalitetit

Ndalohet kryerja e çdo veprimi që përbën shqetësim seksual për vullnetarin. Shqetësim seksual është çdo formë e padëshiruar sjelljeje, e shprehur me fjalë ose veprime fizike e simbolike, me natyrë seksuale, e cila ka për qëllim ose sjell si pasojë cenimin e dinjitetit personal, në mënyrë të veçantë kur krijon një mjedis kërcënues,

armiqësor, poshtërues, përcmues ose fyes, që kryhet nga ofruesi i vullnetarizmit kundrejt një vullnetari ose midis vullnetarëve.

KREU II

KONTRATA E VULLNETARIZMIT

Neni 14

Kontrata e vullnetarizmit

1. Kontrata e vullnetarizmit përcakton të drejtat dhe detyrimet e vullnetarit dhe ofruesit të vullnetarizmit dhe kushtet e kriteret e nevojshme për kryerjen e aktiviteteve dhe shërbimeve vullnetare.

2. Kontrata e vullnetarizmit lidhet në formë të shkruar ndërmjet vullnetarit dhe ofruesit të vullnetarizmit.

Neni 15

Përmbajtja e kontratës

1. Kontrata e vullnetarizmit përmban:

a) identitetin, vendbanimin ose vendqëndrimin e vullnetarit ose prindit/përfaqësuesit ligjor për vullnetarin e mitur;

b) numrin personal të identifikimit të vullnetarit ose prindit/përfaqësuesit ligjor për vullnetarin e mitur;

c) identitetin dhe adresën e ofruesit të vullnetarizmit;

ç) numrin personal të identifikimit të ofruesit të vullnetarizmit;

d) identitetin dhe adresën e përfituesit të vullnetarizmit;

dh) kohëzgjatjen dhe vendin e kryerjes së vullnetarizmit;

e) përshkrimin e vullnetarizmit që do të kryhet;

ë) të drejtat dhe detyrimet e palëve;

f) shkaqet dhe mënyrën e zgjidhjes së kontratës;

g) të dhënat për shpenzimet që kanë të bëjnë me kryerjen e vullnetarizmit dhe mënyrën e kompensimit të tyre.

2. Kontrata mbi vullnetarizmin mund të përmbajë dhe elemente të tjera, për të cilat palët bien dakord për të specifikuar kushtet në të cilat do të kryhet puna, në përputhje me këtë ligj.



Neni 16

Efektet e kontratës

1. Me lidhjen e kontratës së vullnetarizmit, të drejtat që kanë lindur nga papunësia nuk humbasin.

2. Kontratat e vullnetarizmit, që lidhen me qëllim shmangien e lidhjes së një kontrate pune, janë të pavlefshme.

Neni 17

Përfundimi i kontratës

Kontrata e vullnetarizmit përfundon:

- a) kur mbaron perioda për të cilën është lidhur kontrata;
- b) kur vullnetari bëhet i paaftë për të kryer vullnetarizmin;
- c) me marrëveshje ndërmjet palëve;
- ç) me zgjidhje të njëanshme të kontratës.

Neni 18

Zgjidhja në mënyrë të njëanshme e kontratës

1. Vullnetari ose ofruesi i vullnetarizmit mund të zgjidhin në çdo kohë, në mënyrë të njëanshme, kontratën e vullnetarizmit, për shkaqe të justifikuara.

2. Ofruesi i vullnetarizmit mund të zgjidhë kontratën para afatit të mbarimit të saj, kur:

- a) nuk ka më nevojë për vullnetarizëm;
- b) nuk është në gjendje për të siguruar kushtet e nevojshme për kryerjen e vullnetarizmit;
- c) vërteton se vullnetari nuk përmbush detyrimet e kontratës.

3. Vullnetari mund të zgjidhë kontratën para mbarimit të afatit të saj, kur:

- a) nuk është më i aftë për të kryer vullnetarizmin objekt kontrate;
- b) nuk ka më vullnet për të kryer vullnetarizmin objekt kontrate;
- c) ofruesi i vullnetarizmit nuk përmbush detyrimet e kontratës.

4. Kur zgjidhja e kontratës, sipas përcaktimit të pikës 3, shkronja “b”, të këtij neni, sjell pasoja të rënda për vazhdimësinë e punës së ofruesit të vullnetarizmit ose sjell pasoja të rënda mbi palët e treta, vullnetari është i detyruar të vazhdojë marrëdhënien kontraktore deri në përfundimin e afatit të saj.

5. Zgjidhja e njëanshme e kontratës, në çdo rast, bëhet me shkrim. Pala, e cila kërkon zgjidhjen e kontratës, i dërgon njoftimin me shkrim palës tjetër 10 ditë përpara datës së kërkuar për zgjidhjen e kontratës.

KREU III

TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E VULLNETARËVE DHE OFRUESIT TË VULLNETARIZMIT

Neni 19

Të drejtat e vullnetarit

1. Vullnetari ka të drejtë:

- a) të njihet me përshkrimin e vullnetarizmit që do të kryejë;
- b) të informohet për kushtet e punës dhe rreziqet që lidhen me punën që do të kryejë;
- c) të kërkojë marrjen e masave të sigurisë teknike gjatë kryerjes së punës;
- ç) të informohet nga ofruesi i vullnetarizmit për rregullat e përgjithshme të punës dhe rregullat e etikës së vullnetarit;
- d) të trajnohet, nëse është e nevojshme, në përputhje me natyrën e punës që do të kryejë;
- dh) të pajiset me librezë vullnetari;
- e) të përfitojë pushime ditore në kohëzgjatjen e vullnetarizmit në rast se ka shkaqe të arsyeshme dhe të provueshme, si sëmundje etj.;
- ë) të përfitojë pushime midis orëve të kryerjes së vullnetarizmit, në varësi të llojit të vullnetarizmit që kryen;
- f) të kërkojë mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Koha e mungesës së justifikuar, e përcaktuar në pikën 1, shkronja “e”, të këtij neni, llogaritet në kohëzgjatjen e kontratës së vullnetarizmit dhe nuk mund të jetë arsye për humbjen e të drejtave të vullnetarit të përcaktuara në këtë kontratë.

3. Vullnetari ka të drejtë të mos zbatojë udhëzimet e ofruesit të vullnetarizmit nëse:

- a) udhëzimet përbëjnë rrezik real për jetën, shëndetin, dhe integritetin fizik të tij;
- b) udhëzimet janë në shkelje të legjislacionit në fuqi ose përcaktimeve të kontratës së vullnetarizmit.



Neni 20

Përgjegjësitë e vullnetarit

Vullnetari ka këto përgjegjësi:

- a) të kryejë vullnetarizmin, në përputhje me kontratën e vullnetarizmit;
- b) të ofrojë shërbimin personalisht dhe drejt-përdrejt, në përputhje me standardet dhe etikën profesionale, kur ofrimi i shërbimeve kërkon aftësitë profesionale;
- c) të marrë pjesë në trajnime për të përmirësuar cilësinë e punës;
- ç) të respektojë integritetin, misionin dhe objektivat e ofruesit të vullnetarizmit;
- d) të ruajë sekretin profesional, me të cilin njihet për shkak të natyrës së punës që kryen;
- dh) të informojë me shkrim ofruesin e vullnetarizmit për çdo rrezik ose dëm real që mund t'i vijë atij vetë, ofruesit apo palëve të treta, të cilin e konstaton gjatë kryerjes së vullnetarizmit;
- e) të informojë paraprakisht ofruesin e vullnetarizmit në rast sëmundjeje ose gjendjeje tjetër që e pengon atë në kryerjen e vullnetarizmit.

Neni 21

Përgjegjësitë e ofruesit të vullnetarizmit

1. Ofruesi i vullnetarizmit ka për detyrë:

- a) të ofrojë vullnetarizmin, në bazë të kushteve dhe detyrimeve të kontratës së vullnetarizmit;
- b) të sigurojë kushtet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e vullnetarizmit;
- c) të lëshojë një vërtetim me shkrim me të dhëna për vullnetarizmin e kryer nga vullnetari;
- ç) të plotësojë librezën e vullnetarit;
- d) të ruajë konfidencialitetin e të dhënave personale të vullnetarit;
- dh) t'i sigurojë vullnetarit pagesën e shpenzimeve të nevojshme për kryerjen e vullnetarizmit, si shpenzime transporti, shpenzime trajnimi, shpenzime ushqimi, si dhe çdo shpenzim tjetër që përcaktohet në kontratën e vullnetarizmit.

2. Ofruesi i vullnetarizmit mban një regjistër për kontratat e vullnetarizmit dhe njofton Shërbimin Kombëtar të Punësimit brenda një periudhe prej 10 ditëve nga data e përfundimit të kontratës së vullnetarizmit. Forma dhe përmbajtja e këtij regjistri përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet e punësimit.

Neni 22

Sigurimi i shëndetit për vullnetarin

1. Ofruesi i vullnetarizmit detyrohet të sigurojë vullnetarin në rast të aksidenteve apo sëmundjeve që ndodhin gjatë kohëzgjatjes së kontratës së vullnetarizmit, kur këto lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me vullnetarizmin e kryer.

2. Ofruesi i vullnetarizmit është i detyruar t'i japë vullnetarit një kopje të kontratës së sigurimit të shëndetit dhe aksidenteve, brenda 3 ditëve nga firmosja e kontratës së vullnetarizmit.

Neni 23

Shpërblimi për dëmet

1. Vullnetari përgjigjet ndaj ofruesit të vullnetarizmit, nëse shkakton dëme gjatë kryerjes së vullnetarizmit, me dashje ose nga pakujdesia.

2. Vullnetari përgjigjet ndaj palës së tretë përfshirë edhe një përfitues të vullnetarizmit, për dëmet e shkaktuara gjatë kryerjes së vullnetarizmit, me dashje ose nga pakujdesia, përveç rasteve kur vullnetari ka vepruar në mirëbesim, sipas udhëzimeve të ofruesit të vullnetarizmit.

3. Vullnetari shkarkohet nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar gjatë kryerjes së vullnetarizmit, në rast se ka informuar ofruesin e vullnetarizmit, sipas përcaktimeve të nenit 20, shkronja "dh", të këtij ligji.

4. Ofruesi i vullnetarizmit përgjigjet për dëmet e shkaktuara vullnetarit gjatë ose në lidhje me kryerjen e vullnetarizmit, kur këto kanë ardhur si rezultat i mospërmbyshjes prej tij të detyrimeve të kontratës së vullnetarizmit.

5. Kërkimi i dëmit, në çdo rast, bëhet në bazë të legjislacionit në fuqi për kërkimin e dëmit.

KREU IV**REGJISTRIMI DHE MONITORIMI I VULLNETARIZMIT**

Neni 24

Autoriteti përgjegjës

Autoriteti përgjegjës për monitorimin e zbatimit të këtij ligji është ministria përgjegjëse për çështjet e punës.



Neni 25

Shërbimi Kombëtar i Punësimit

1. Shërbimi Kombëtar i Punësimit mban bazën e të dhënave të ofruesve të vullnetarizmit dhe vullnetarëve, të bazuara në të dhënat e dërguara nga ofruesit e vullnetarizmit.

2. Shërbimi Kombëtar i Punësimit bën plotësimin e librezës së vullnetarit, në rastin e vullnetarit shqiptar që kryen vullnetarizëm jashtë Shqipërisë, pasi të ketë vlerësuar vërtetësinë e vërtetimeve apo certifikatave që dorëzon vullnetari.

Neni 26

Libreza e Vullnetarit

1. Çdo vullnetar pajiset me librezën e vullnetarit nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

2. Forma dhe përmbajtja e librezës së vullnetarit përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet e punësimit.

Neni 27

Kodi i Etikës së Vullnetarit

Kodi i Etikës së Vullnetarit miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për çështjet e punësimit.

Neni 28

Inspektimi

Inspektorati që mbulon çështjet e punës siguron kontrollin për zbatimin e përcaktimeve të këtij ligji, në çdo rast të kryerjes së vullnetarizmit.

KREU V

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 29

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 27.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për çështjet e punësimit, që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 21, pika 2, dhe 26, pika 2.

Neni 30

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 28.4.2016

Shpallur me dekretin nr. 9607, datë 24.5.2016 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

LIGJ**Nr. 49/2016**

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9693, DATË 19.3.2007, “PËR FONDIN KULLOSOR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Në ligjin nr. 9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullor”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në të gjithë ligjin:

- emërtimi “drejtori rajonale e shërbimit pyjor” zëvendësohet me emërtimin “struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki”;
- termi “komunë” zëvendësohet me termin “bashki”;
- termi “kullotë komunale” zëvendësohet me termin “kullotë bashkiake”;
- termi “organe të qeverisjes vendore” zëvendësohet me termin “bashki”.

Neni 2

Në nenin 5, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

- “1. Fondi kullor, sipas pronësisë, ndahet në:
- a) fond kullor shtetëror, që përmbledh kullotat dhe livadhet në pronësi të bashkisë, në territorin administrativ të së cilës ndodhen;
 - b) fond kullor privat, që përmbledh kullotat dhe livadhet në pronësi private.”.



Neni 3

Në nenin 7, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Bashkitë dhe pronarët privatë të kullotave e livadheve i japin ministrisë përgjegjëse për kullotat dhe livadhet të dhëna të nevojshme për inventarizimin e kullotave që zotërojnë, në përputhje me kërkesat e udhëzimit të përmendur në pikën 1 të këtij neni.”.

Neni 4

Në nenin 14, pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Planet e mbarështimit të kullotave, para se të miratohen nga ministri përgjegjës për kullotat dhe livadhet, shqyrtohen nga një komision teknik, në përbërje të të cilit është edhe një përfaqësues i bashkisë. Komisioni ngrihet me urdhër të ministrit.”.

Neni 5

Neni 24 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 24

Ministria përgjegjëse për kullotat dhe livadhet

1. Ministria është organi qendror përgjegjës për mbrojtjen dhe miradministrimin e fondit kullor, pjesë e zonave të mbrojtura.

2. Ministria është organi qendror përgjegjës për hartimin e politikave dhe kuadrit ligjor, me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm të fondit kullor. Ajo drejton dhe organizon:

a) hartimin e politikave, të strategjive, planeve të veprimit e të mbarështimit në nivel kombëtar, për zhvillimin dhe menaxhimin e integruar të kullotave e livadheve, ruajtjen e mjedisit, të ekuilibrit biologjik dhe të biodiversitetit në fondin kullor;

b) sigurimin e zbatimit të kërkesave të këtij ligji e të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij;

c) hartimin e programeve studimore dhe kryerjen e veprimtarive kërkimore-shkencore, në bashkëpunim me organet e specializuara kërkimore-shkencore e me departamentet e Universitetit Bujqësor;

ç) planifikimin dhe përdorimin e fondeve për studime në ekonominë kullorë, për vlerësimin dhe rritjen e aftësisë mbajtëse të kullotave dhe livadheve, si dhe për kryerjen e punimeve e të

ndërtimeve në to, sipas projekteve, në nivel kombëtar;

d) punën për përcaktimin e ekonomive kullorë dhe ndarjen e tyre në ngastra e nënngastra;

dh) zgjerimin e mundësive për rritjen e investimeve private në kullota e livadhe dhe angazhimin e bizneseve në to;

e) promovimin e zgjidhjeve e të rrugëve të reja, për trajtim bashkëkohor të kullotave, për rritjen e përdorimit racional të tyre.”.

Neni 6

Neni 26 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 26

Kompetencat e bashkive dhe të pronarëve privatë

Bashkitë janë pronarë të kullotave shtetërore që gjenden brenda territorit administrativ të tyre. Bashkitë dhe pronarët privatë, që zotërojnë kullota dhe livadhe, kanë këto kompetenca:

a) ruajnë, administrojnë dhe i përdorin kullotat dhe livadhet, në përputhje me kërkesat e këtij ligji e të akteve nënligjore, të dala në zbatim të tij;

b) hartojnë, me shpenzimet e veta, planet e mbarështimit të kullotës apo livadhit, të cilat miratohen nga ministri përgjegjës për kullotat dhe livadhet;

c) marrin masa për parandalimin e zjarreve dhe për shuarjen e tyre;

ç) raportojnë në ministrinë përgjegjëse për kullotat dhe livadhet të dhënat, që u kërkohen për inventarizimin dhe regjistrimin në regjistrin e fondit kullor të kullotave dhe livadheve, në përputhje me formularët tip;

d) njoftojnë ministrinë përgjegjëse për kullotat dhe livadhet për infeksionet dhe dëmtuesit, që shfaqen në kullota e livadhe.”.

Neni 7

Në nenin 29, pika 2 shfuqizohet.

Neni 8

Neni 31 ndryshohet si më poshtë:



“Neni 31

Vendimi dhe e drejta ankimit

1. Vendimi për kundërvajtjet administrative merret nga Policia Pyjore, në zbatim të legjislacionit në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.

2. Ndaj vendimit të dhënë në zbatim të pikës 1, të këtij neni, bëhet ankim, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

3. Procedura e ekzekutimit të vendimit të dënimit me gjobë bëhet në përputhje me ligjin për kundërvajtjet administrative.”.

Neni 9

Dispozitë kalimtare

Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për kullotat, brenda 3 muajve nga data

e hyrjes në fuqi të këtij ligji, miraton transferimin e kullotave në pronësi të bashkive.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 5.5.2016

Shpallur me dekretin nr. 9608, datë 24.5.2016 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 84 lekë